



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	25-05-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEMSTHCK	4416/2023		119



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.740/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.740/2023 të datës 16.05.2023 të parashtruar nga ankuesit

, të cilët me autorizim i përfaqëson Av avokat në Komunën e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Qendra e Studentëve, në çështjen juridike-administrative "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.05.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të për ankesën me numër A.nr.740/2023 të datës 16.05.2023, të parashtruar nga ankuesit

dhe

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës.



## Ar sy e t i m

Ankuesit përmes përfaqësueses me autorizim, me datën 16.05.2023 përmes Postës së Kosovës, kanë parashtruar ankesën me numër protokoll 4253/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.125 të datës 22.02.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës së Studenteve, me pretendimet ankimore se ankuesve në fjalë ndërrimi i orarit të ri të punës nuk u konvenon për shkak se pjesa më e madhe e këtyre punonjësve udhëtojnë nga komuna të ndryshme, po ashtu të njëjtit pretendojnë se me orarin e ri të punës janë krijuar edhe shpenzime për shkak se ka punonjës të cilët udhëtojnë nga qytetet tjera jashtë Prishtinës, të njëjtit theksojnë faktin se kanë kërkuar edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve që të kthehet orari i mëparshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se të gjithë ankuesit e lartcekur në bazë të Akt emërimeve të cilat i posedojnë mbajnë pozitën e punës "Receptionist" në kuadër të Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës, rrjedhimisht ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 17.12.2013 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 29.08.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesja \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 23.03.2020 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 27.08.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 28.05.2019 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 23.09.2019 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 29.08.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi Anton Lani në bazë të Akt emërimit me numër AE.Nr.28/2022 të datës 10.02.2022 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 03.07.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 17.07.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 28.08.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesja \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit me numër AE.Nr.27/2022 të datës 10.02.2022 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 01.02.2015 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 04.01.2013 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit me numër AE.Nr.26/2022 të datës 10.02.2022 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 17.07.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 12.10.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 01.10.2014 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 17.07.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 24.09.2019 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 28.08.2012 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 27.05.2020 mban pozitën e punës "Receptionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës \_\_\_\_\_



28.08.2012 mban pozitën e punës "Recpsionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 17.12.2013 mban pozitën e punës "Recpsionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 15.10.2012 mban pozitën e punës "Recpsionist", ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 01.07.2012 mban pozitën e punës "Recpsionist", ankuesja \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 05.06.2017 mban pozitën e punës "recpsionist" si dhe ankuesi \_\_\_\_\_ në bazë të Akt emërimit të datës 02.02.2015 mban pozitën e punës "Recpsionist".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës* si dhe bazuar në paragrafin 6 te të njëjtit nen ku theksohet se: *"Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"*, konstatoi se pozita "Recepsionist" hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit administrativ dhe mbështetës, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.134/2022 të datës 15.02.2022 të parashtruar nga ankuesit.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.740/2023 të datës 16.05.2023, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës.


Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, konstaton se nëpunësit *administrativo-teknik dhe mbështetës* fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.740/2023.

Ardita Perçuku-SHYTI  
  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI  
  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësueses me autorizim të ankuesve Av.
- Komisionit për Ankesa në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Qendrën e Studentëve në Universitetin e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

